

	<b>Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</b> <b>FTESË PËR OFERTIM</b>	<b>KN CIGRE KO</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 / 2</i>

**Ref: 01/CIGRE/2020**

Datë: 11.03.2020

## FTESË PËR OFERTIM

### “AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2019”

**Data e publikimit:** 11 mars 2020 (E Mërkure)

**Data e mbylljes:** 20 mars 2020, ora 16:00 (E Premte)

**Data e njoftimit:** Më së largu me 24 mars 2020 (E Marte)

**Objekti i kontratës:** Marrëveshje e shërbimit

**Autoriteti kontraktues:** Shoqata Elektroteknike e Kosovës  
 Komiteti Nacional CIGRE Kosovë (KN CIGRE KO)

#### 1. HYRJE

Shoqata Elektroteknike e Kosovës – Komiteti Nacional CIGRE Kosovë fton kompanitë audituese që të ofertojnë për të kryer shërbimet e auditimit sipas SNRF(angl. IFRS) dhe rregullave të ATK-së për vitin financiar prej 01.01.2019 deri me 31.12.2019.

#### 2. SHËRBIMI I KËRKUAR

- Auditimi i pasqyrave financiare për vitin fiskal që mbyllet me 31.12.2019 të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe legjislacionit në fuqi për OJQ në Kosovë.
- Auditimi duhet të bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Raporti i Auditimit kërkohet të paraqitet në dy gjuhë: **në Shqip dhe në Anglisht.**
- Raporti Përfundimtar i Auditimit kërkohet të dorëzohet me dt. **30 Mars 2020**

#### 3. KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

Ofertuesit e interesuar, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata e regjistrimit fiskal;
- Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve;
- Referenca mbi kryerjen e auditimeve të OJQ-ve;
- CV-të e auditorëve që do të bëjnë auditimin.

Oferta duhet të përmbajë:

- Planin e Punës të Procesit të Auditimit;
- Afatin kohor të propozuar – periudhën e auditimit;
- Kërkesa për dokumentacionet që duhen të përgatiten paraprakisht nga ana e OJQ-së;
- Shumën totale të kostos financiare të auditimit (Në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, Shoqata do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH-në).

#### 4. UDHËZIME PËR DORËZIM TË OFERTAVE

- Ofruesit e Shërbimit duhet të dërgojnë ofertat e tyre, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme, deri më **20 Mars 2020, ora 16:00**;
- Oferta duhet të dorëzohet vetëm në formë elektronike përmes e-mailit në adresën elektronike: [info@cigre-ks.com](mailto:info@cigre-ks.com), duke shënuar në Subject numrin e ftesës për ofertim: **Ref: 01/CIGRE/2020**
- Të gjitha Ofertat do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e vlerësimit sipas pikës 5. Kriteret e Vlerësimit.

#### SHËNIM:

- Të gjitha dokumentet e mësipërme mund të paraqiten në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze.

#### 5. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	
1.1 Historiku dhe përvoja e kompanisë audituese	20
1.2 Referenca me OJQ duke përfshi edhe detaje të kontaktit ( <i>min. 3 referenca</i> )	20
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1 Oferta ekonomikisht më e favorshme	60
<b>Totali:</b>	<b>100</b>

---

Për çdo pyetje mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes e-mailit në këtë adresë:  
[info@cigre-ks.com](mailto:info@cigre-ks.com).

Kërkesat me shkrim pranohen deri me datë **19 Mars 2020, ora 14:00**.